



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. të parashtruar me datë 02.10.2023 në ora 11:25 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET** poshtë si e palejuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. të parashtruar me datë 02.10.2023 në ora 11:25 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj procedurën për aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Rojet e nderit" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.10.2023 në ora 11:25 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-5765-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se parashtruesi të njëjtën kërkesë për rishqyrtim e ka parashtruar dy herë për të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe kundër të njëjtit njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues. Njëren kërkesë e ka parashtruar me datë 02.10.2023 në ora 11:15 ndërsa tjetrën (kjo për të cilën është nxjerrë ky vendim) është parashtruar me datë 02.10.2023 në ora 11:25.

Duke qenë autoriteti kontraktues e ka trajtuar kërkesën e parë për rishqyrtim të datës 02.10.2023 në ora 11:15, atëherë nuk është e nevojshme që të shqyrtohet edhe kjo kërkesë për rishqyrtim. Me fjalë të tjera vendimi i autoritetit kontraktues që është publikuar në platformën E-Prokurimi me datë 09.10.2023 dhe me të cilën është vendosur mbi kërkesën për rishqyrtim të datës 02.10.2023 të parashtruar në ora 11:15, si i tillë përbën çështje të gjykuar (res judicata) sa i përket kërkesës për rishqyrtim të parashtruar me datë 02.10.2023 në ora 11:25. Në këtë drejtim duke u bazuar në parimin *ne bis in idem* nuk lejohet vendosja mbi çështjen e njëjtë më shumë se një herë. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.